



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr *17* Datë 11.02 .2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015** “ Për vetqeverisjen vendore”, **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016** “ Për Prefektin e Qarkut “, **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019** “ Për Mbrojtjen Civile”, **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012** “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” **kreu III, pika 1, gërma ë**, dhe Vendimit **nr. 76 prot datë 02. 08. 2017, pika I**, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, me 16 vota pro

VENDOSI :

- I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
- II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 kat** në pronësi të **z. Safet Imeraj** njësia administrative Sllovë (fshati Zall - Kalis) në shumën totale **97002** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **97002** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **ska**.
- III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **48501** lekë (50 % të vlerës totale të dëmit).
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Sekretare Këshilli

Inva TRUPJA

Kryetar Këshilli

Sokol SAVA

